



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT

LIGJ

Nr. ____ datë _____

**PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE, IMPIANTEVE DHE
INSTALIMEVE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

1. Garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike në pronësi dhe/ose përdorim të operatorëve ekonomike privatë dhe/ose publikë si dhe përcaktimi i kërkesave thelbësore të sigurisë që duhet të përmbushen prej tyre.
2. Përcaktimi i “*funksionit të inspektimit*” sipas kërkesave të nenit 11 të ligjit 10433/2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*” në fushën e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.
3. Përcaktimi i detyrave, të drejtave dhe kompetencave të Inspektoratit Shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike.
4. Përcaktimi i detyrave të trupave inspektuese “palë të treta” për vlerësimin e konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji janë pajisjet, impiantet, instalimet elektrike të vëna në shërbim me tension mbi 50 volt të rrymës alternative (a.c) dhe mbi 75 volt të rrymës së vazhduar (d.c.). Bëjnë

përrjashtim nga objekti i këtij ligji pajisjet, impiantet, instalimet të cilat për nga natyra e tyre trajtohen me një ligj të veçantë.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Vendosje në shërbim e pajisjes, impiantit, instalimit elektrik”** është vendosja në përdorim për herë të parë e një pajisje, impianti, instalimi elektrik prej operatorëve ekonomikë që i kanë në pronësi dhe/ose përdorim ato.
2. **“Produkt elektrik”** është çdo send i ri apo i përdorur, i cili është prodhuar, nxjerrë ose përfutur, pavarësisht nga niveli i përpunimit, i destinuar për t’u përdorur në pajisje, impiante dhe/ose instalime elektrike. Bëjnë përrjashtim nga ky përkufizim produktet elektrike të destinuara për konsumatorët.
3. **“Pajisje elektrike”** është bashkësia e disa produkteve elektrike dhe/ose jo elektrike që të montuara së bashku shërbejnë për kryerjen e një funksioni/proçesi elektrik. Bëjnë përrjashtim nga ky përkufizim pajisjet elektrike të destinuara për konsumatorët.
4. **“Konsumator”** është çdo person, i cili blen ose përdor produkte dhe/ose pajisje elektrike për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit. Në kuptim të këtij ligji, edhe organizatat jofitimprurëse konsiderohen si konsumatorë.
5. **“Instalim elektrik”** është bashkësia e produkteve elektrike dhe pajisjeve elektrike të montuara së bashku, që shërbejnë për kryerjen e një funksioni/proçesi teknik elektrik. Në këtë përcaktim përrfshihen edhe instalimet e brendshme dhe të jashtme të objekteve si dhe linjat elektrike të çdo lloji.
6. **“Përdorim”** është çdo veprim i lidhur me montimin (instalimin), vënien në shfrytëzim, riparimin, modifikimin, mirëmbajtjen, duke përrfshirë edhe pastrimin e pajisjes, impiantit, instalimit elektrik. Bën përrjashtim nga ky përkufizim përdorimi i pajisjes elektrike të destinuara për konsumatorët.
7. **“Aksesorë sigurie”** janë dispozitivët e projektuar dhe prodhuar për mbrojtjen dhe kontrollin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike nga tejkalimi i kufijve të lejuar të parametrave teknike. Këtu përrfshihen edhe dispozitivët për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe kafshëve nga kontakti aksidental me pjesët përcjellëse të rrymës elektrike.
8. **“Montimi (instalimi) i pajisjeve elektrike”** është procesi i bashkimit të produkteve, pajisjeve elektrike dhe aksesorëve të tyre të sigurisë, në përputhje me projektin përkatës, me qëllim realizimin e një funksioni/proçesi teknik të caktuar.
9. **“Prodhues”** është personi juridik/fizik, i cili prodhon një produkt ose pajisje elektrike dhe e vendos atë në treg nën emrin apo markën e tij tregtare.
10. **“Operator ekonomik”**, në kuptim të këtij ligji, është çdo subjekt prodhues apo përfaqësuesi i tij i autorizuar, importues, shpërndarës, montues, mirëmbajtës dhe

përdorues i produkteve, pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike në funksion të një veprimtarie ekonomike.

11. **“Montues ose instalues”** është operatori ekonomik i licencuar sipas legjislacionit në fuqi, për të kryer montime ose instalime të pajisjeve, impianteve dhe/ose instalimeve elektrike.
12. **“Ndalim i përdorimit”** është masa që merret nga inspektorati shtetëror përgjegjësi cili ndalon përdorimin e mëtejshëm të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik që nuk plotëson kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në këtë ligj dhe rregullat teknike në fuqi, deri në rikthimin e tyre në kushtet e sigurisë.
13. **“Mbikëqyrja e tregut të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike”** janë veprimtaritë e kryera nga inspektorati shtetëror përgjegjës në përputhje me përcaktimet e ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore si dhe të këtij ligji, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore në lidhje me to, me qëllim që të mos rrezikohet shëndeti i njerëzve, kafshëve, pronës dhe mjedisit.
14. **“Palë të treta”** janë organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit.
15. **“Organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit”** (OMVK) janë organizma të miratuara nga ministri përgjegjës për energjinë elektrike në përputhje me legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.
16. **“Çertifikatë inspektimi”** është dokumenti i lëshuar nga OMVK në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të përshkruara në rregullat teknike përkatëse, me të cilin OMVK konkludon se janë plotësuar kërkesat teknike lidhur me pajisjen, impiantin, instalimin elektrik të verifikuar (inspektuar).
17. **“Raport inspektimi”** është dokumenti i lëshuar nga OMVK në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të përshkruara në rregullat teknike përkatëse, në të cilin OMVK pasqyron gjetjet e konstatuara nga inspektimi teknik për pajisjen, impiantin, instalimin elektrik, lidhur me plotësimin e kërkesave të sigurisë.
18. **“Raport testimi”** është dokumenti i lëshuar nga OMVK në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të përshkruara në rregullat teknike përkatëse, në të cilin OMVK pasqyron rezultatet e testeve dhe/ose provave të kryera në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike, lidhur me plotësimin e kërkesave të sigurisë.
19. **“Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike”** është organi shtetëror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë elektrike, që kryen veprimtarinë e parashikuar në këtë ligj dhe çdo ligj tjetër të zbatueshëm.
20. **“Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë”** është marrëveshja e nënshkruar ndërmjet operatorit ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, me një shoqëri sigurimi, që siguron mbulimin e dëmeve ndaj jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit që mund të shkaktohen nga mosfunksionimi ose keqfunksionimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike që ai ka në pronësi dhe/ose përdorim.

21. “**Libër i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike**” është dokumenti, në të cilin pasqyrohen të dhënat në lidhje me parametrat teknike, kohën e prodhimit apo montimit, subjektin që e ka në pronësi dhe/ose përdorim, rezultatet e inspektimeve teknike të tyre. Ky dokument administrohet nga operatori ekonomik dhe vihet në dispozicion të inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit, sipas kërkesave ligjore në fuqi.
22. “**Regjistër i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike**” është dokumenti, në të cilin pasqyrohen të dhënat lidhur me pajisjen, impiantin, instalimin elektrik, përfshirë kohën e prodhimit apo montimit, subjektin që i ka ato në pronësi dhe/ose përdorim, rezultatet e vlerësimit të konformitetit të kryera ndaj tyre. Ky dokument administrohet prej inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe bëhet i disponueshëm edhe ndaj organeve të tjera shtetërore, sipas kërkesave ligjore në fuqi.
23. “**Deklaratë konformiteti**” është dokumenti i hartuar nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit (për produktet elektrike) apo, sipas rastit, të instaluesit të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, në të cilin përshkruhen të gjitha aktet ligjore, nënligjore dhe rregullat teknike të zbatueshme ndaj produktit, pajisjes, impiantit, instalimit elektrik.
24. “**Deklaratë përputhshmërie**” është dokumenti i hartuar dhe i lëshuar për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike që janë montuar (instaluar) para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
25. “**Mirëmbajte**” e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike është tërësia e shërbimeve të nevojshme që kryhet ndaj tyre me qëllim ruajtjen e parametrave teknike të sigurisë së funksionimit për të cilin ato janë projektuar dhe montuar (instaluar).
26. “**Rikonstrukcion**” i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike është ndërhyrja në to duke ndryshuar parametrat fillestare të projektuara dhe të zbatuara me qëllim përshtatjen e tyre me nevoja të reja të përdorimit, shërbimit dhe funksionimit të pajisjes, impiantit dhe/ose instalimit elektrik.
27. “**Rregull teknik**” është dokumenti teknik që përcakton kërkesat minimale teknike të detyrueshme për zbatim për një pajisje, impiant, instalim elektrik.
28. “**Ministria**” është ministria përgjegjëse për energjinë elektrike.
29. “**Ministri**” është ministri përgjegjës për energjinë elektrike.

KREU II

PROJEKTIMI I, PAJISJEVE, IMPIANTEVE, INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Neni 4

1. Të gjitha pajisjet, impiantet, instalimet elektrike montohen (instalohen) dhe vihen në shfrytëzim në përputhje me projektin teknik përkatës, të hartuar nga operatorë ekonomike projektues të licencuar sipas legjislacionit në fuqi.
2. Operatori ekonomik projektues harton projektin teknik në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi, dhe mban përgjegjësi për projektin e hartuar.

3. Përpara fillimit të procedurës së montimit (instalimit) të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, projekti teknik i nënshtrohet vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit.
4. Organi i miratuar i Vlerësimit të Konformitetit pas shqyrtimit të projektit, lëshon “Certifikatë Inspektimi” për projektin e hartuar nëse projekti plotëson kërkesat ligjore e nënligjore të aplikuashme dhe/ose “Raport Inspektimi” nëse projekti i hartuar përmban mangësi lidhur me kërkesat ligjore e nënligjore të aplikuashme.
5. Kriteret teknike dhe profesionale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë projektues të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, përcaktohen përcaktohen me Urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë elektrike.
6. Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë që kanë në pronësi dhe ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, duke zbatuar detyrimet e përcaktuara në ligjin për inspektimin.

KREU III

MONTIMI I PAJISJEVE, IMPIANTEVE, INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Neni 5

Montimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.

1. Montimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike kryhet vetëm nga operatorë ekonomikë instalues të licencuar sipas legjislacionit në fuqi.
2. Instaluesi kryen montimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike përkatëse, dhe është përgjegjës për garantimin e kërkesave të sigurisë së pajisjes, impiantit, instalimit elektrik të montuar (instaluar) prej tyre.
3. Instaluesi plotëson një dosje me të dhëna të plota mbi produktet, pajisjet elektrike të përdorura gjatë instalimit, të cilat reflektohen edhe në librin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
4. Pas përfundimit të montimit të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, instaluesi që ka kryer montimin (instalimin), lëshon për llogari të pronarit dhe/ose përdoruesit të tyre “Deklaratë Konformiteti” për pajisjen, impiantin, instalimin elektrik.
5. Pas përfundimit të montimit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike dhe para vendosjes së tyre në shërbim/shfrytëzim, ato duhet t`u nënshtrohen vlerësimit të konformitetit nga organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit. Organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit në rast se konstatojnë përputhshmëri të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike të montuara me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi lëshojnë “Çertifikatë inspektimi” të shoqëruar me “Raportet e Inspektimit” dhe “Raportet e Testimit” që mbështesin këtë çertifikatë. Në rast të konstatimit të mospërputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi lëshojnë vetëm “Raportet e Inspektimit” dhe/ose “Raportet e Testimit” në të cilat evidentohen mospërputhshmëritë e konstatuara.

6. Kërkesat teknike dhe profesionale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomike instalues të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, përcaktohen me Urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë elektrike.

Neni 6

Deklarata e konformitetit dhe Deklarata e përputhshmërisë

1. Çdo produkt, pajisje, impiant, instalim elektrik, përpara vendosjes në treg dhe/ose vënjes në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit, të lëshuar nga prodhuesi dhe sipas rastit montuesi ose instaluesi, në të cilën pasqyrohet përputhshmëria me rregullat teknike të aplikueshme dhe legjislacionin në fuqi.
2. Montimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike bëhet nga operatorë ekonomike instalues të pajisur me licencat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Çdo impiant, instalim elektrik i montuar (instaluar) para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk është i pajisur me deklaratën e konformitetit sipas pikës 1 të këtij neni, duhet që brenda një afati 2 vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të pajiset me “Deklaratën e përputhshmërisë” të lëshuar nga një operator ekonomik projektues dhe/ose instalues i licensuar në këtë fushë.
4. Modeli i deklaratës së konformitetit dhe modeli i deklaratës së përputhshmërisë jepen në rregullat teknike në fushën e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.

Neni 7

Regjistrimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike

1. Para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në pronësi dhe/ose përdorim impiantin, instalimin elektrik, është i detyruar ta regjistrojë atë pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.
2. Regjistrimi bëhet pasi operatori ekonomik ka depozituar, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës kërkesën dhe të dhënat teknike të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, deklaratat e konformitetit të lëshuar nga prodhuesi dhe/ose montuesi (instaluesi) si dhe specifikimet teknike të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik. Regjistrimi përmban:
 - a) emrin dhe adresën e operatorit ekonomik (personit përgjegjës) që ka në pronësi dhe/ose përdorim ato.
 - b) emrin dhe adresën e montuesit (instaluesit) të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, përfshirë një kopje të deklaratës së konformitetit të lëshuar prej tij.
 - c) karakteristikat e pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, përfshirë numrin serial dhe të dhëna të tjera teknike të aplikueshme;
 - d) referencat, ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar, ose ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti.
3. Të dhënat e këtij regjistri ruhen përgjithmonë në bazën e të dhënave të Inspektoratit shtetëror përgjegjës.

4. Regjistri i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike përdoret nga Inspektoratit shtetëror përgjegjës për planifikimin e inspektimeve.
5. Çregjistrimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike të regjistruara në bazën e të dhënave të Inspektoratit shtetëror përgjegjës bëhet me kërkesë të operatorit ekonomik që ka kërkuar regjistrimin jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga heqja e tyre nga puna/shfrytëzimi.

KREU IV

SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE, IMPIANTEVE, INSTALIMEVE

ELEKTRIKE

Neni 8

Përgjegjësitë e operatorit ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike.

1. Operatori ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim, pajisje, impiante, instalime elektrike, duhet:
 - a) të marrë masa që të sigurojë jetën dhe shëndetin e punëmarrësve që shfrytëzojnë (përdorin) ato në përputhje me legjislacionin përkatës për sigurinë në punë të punëmarrësve;
 - b) të vendosë në shfrytëzim (përdorim) vetëm pajisje, impiante, instalime elektrike që plotësojnë kërkesat e sigurisë, në përputhje me këtë ligj, legjislacionin përkatës dhe rregullat teknike në fuqi;
2. Operatori ekonomik që shfrytëzon (përdor) pajisje, impiante, instalime elektrike duhet të marrë masat e duhura që gjatë përdorimit (përdorimit) të tyre, ato të mirëmbahen në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat ligjore e teknike lidhur me sigurinë
3. Operatori ekonomik që shfrytëzon (përdor) pajisje, impiante, instalime elektrike, detyrohet t'ia nënshtroje ato vlerësimit të konformitetit nga organizma të miratuara të vlerësimit të konformitetit brenda afateve kohore të percaktuara në rregullat teknike përkatëse si dhe në këtë ligj.
4. Operatori ekonomik që shfrytëzon (përdor) pajisje, impiante, instalime elektrike, për të vlerësuar shkallën e rrezikut, harton një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut elektrik i cili duhet të përmbajë masa me karakter teknik e organizativ, të cilat duhet të zbatohen prej punëmarrësve dhe/ose përdoruesve të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike përkatës në kushtet specifike të ushtrimit të veprimtarisë.
5. Operatori ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdor pajisje, impiante, instalime elektrike merr masa që punëmarrësit të disponojnë të dhënat dhe udhëzimet e duhura të përdorimit të tyre gjatë procesit të punës. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike duhet të përmbajnë, të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin për sa u përket:

- a) kushteve të shfrytëzimit (përdorimit) të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike;
 - b) situatave anormale të parashikueshme;
 - c) dhënies së ndihmës së parë mjekësore, në rast aksidenti.
6. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësin.
7. Operatori ekonomik ka përgjegjësinë që në çdo rast përdorimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike të bëhen nga punëmarrës që kanë aftësi dhe përgatitje të dokumentuar me “Dëshmi aftësie”, të lëshuar nga një organizëm certifikues personeli i miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë elektrike. Ministri miraton vetëm organizma të akredituara në fushën e certifikimit të personelit.

Neni 9

Vënia në shfrytëzim e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike

1. Vënia në shfrytëzim e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike bëhet vetëm pasi janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.
2. Përpara vënies në shfrytëzim të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, operatorët ekonomikë, që kanë në pronësi dhe/ose përdorim ato, duhet të jenë të pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit të tyre. Kontrata duhet të mbulojë përgjegjësinë civile prej dëmeve që mund të shkaktohen nga mosfunksionimi apo keqfunksionimi i tyre.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë elektrike, miraton kategoritë e operatorëve ekonomikë dhe llojet e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike që i nënshtrohen detyrimit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, si dhe kufirin minimal të përgjegjësisë së tyre, që mbulohet nga kontrata e sigurimit.

Neni 10

Mirëmbajtja dhe rikonstruksioni i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike

1. Operatori ekonomik, që ka në pronësi, përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, detyrohet të kryejë mirëmbajtjen e rregullt periodike të tyre, në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullat teknike të aplikueshme.
2. Mirëmbajtja e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike bëhet nëpërmjet shërbimeve teknike, të planifikuara dhe të paplanifikuara, sipas nevojës. Mirëmbajtja mund të kryhet vetëm nga operatorë ekonomike të licencuar në fushën përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, ose nga punëmarrës të operatorit ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim ato. Në rastin e dytë, operatori ekonomik punëmarrës duhet të ketë të punësuar me kontratë të rregullt punësimi punëmarres të kualifikuar në fushën përkatëse dhe të pajisur me dëshmi aftësie sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në çdo rast mirëmbajtja kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi.

3. Rikonstruksioni i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike kryhet vetëm mbi bazën e një projekti teknik rikonstruksioni, të hartuar nga një operator ekonomik projektues i liçencuar sipas kuadrit ligjor në fuqi.
4. Punimet e rikonstruksionit kryhen vetëm nga operatorë ekonomike të liçencuar për fushën përkatëse të punimeve elektrike ose nga punëmarrës të operatorit ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, të kualifikuar dhe të pajisur me dëshmi aftësie përkatëse sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në çdo rast rikonstruksioni i pajisjeve, impianteve instalimeve elektrike kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi.
5. Pas kryerjes së rikonstruksionit dhe para rivendosjes së tyre në shfrytëzim (përdorim), pajisjet, impiantet, instalimet elektrike duhet t'u nënshtrohen inspektimit nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit. Organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit edhe në këtë rast veprojnë në përputhje me procedurat e miratuara.
6. Të gjitha punimet e bëra gjatë fazës së mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit dokumentohen në librin e pajisjes, impiantit, instalimit elektrik të operatorit ekonomik që e ka në pronësi dhe/ose përdorim ato.
7. Ndryshimet e bëra gjatë rikonstruksionit regjistrohen nga operatori ekonomik në regjistrin përkatës të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.

Neni 11

Këqyrja e aksidenteve dhe avarive të rënda

1. Konsiderohet “aksident” në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike çdo ngjarje me pasojë vdekjen ose dëmtimin e shëndetit të një ose me shumë njerezve, ose kafshëve.
2. Konsiderohet “avari e rëndë” në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike çdo ngjarje me pasojë ndërprerjen e funksionimit të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik në përmasa të mëdha dhe për kohe relativisht të gjatë me efekte lokale, rajonale dhe kombëtare, dëmtimin e pronës dhe/ose e mjedisit.
3. Për çdo rast aksidenti dhe/ose avarie të rëndë në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike, pronari, përdoruesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, njofton menjëherë inspektoratin shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike, për këqyrjen e rrethanave dhe konstatimin e shkaqeve. Inspektorati shtetëror përgjegjës për këqyrjen e aksidenteve dhe avarive të rënda bashkëpunon me organet e tjera shtetërore sipas kërkesës së tyre.
4. Ndalohet riparimi apo ndërhyrja në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike në të cilat ka ndodhur një aksident dhe/ose avari e rëndë deri në përfundimin e këqyrjes nga ana e inspektoratit shtetëror përgjegjës, përveç rastit kur inspektorati shtetëror përgjegjës jep një miratim paraprak.
5. Pronari dhe/ose përdoruesi ose përfaqësuesi i autorizuar i pajisjes, impiantit, instalimit elektrik në të cilin ka ndodhur një aksident, avari e rëndë i tij është i detyruar të vërë në

dispozicion të inspektoratit shtetëror përgjegjës çdo të dhënë që i kërkohet për këqyrjen e aksidentit dhe/ose avarisë së rëndë.

6. Pas përfundimit të këqyrjes së aksidentit, avarisë së rëndë, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike harton raportin përkatës, në të cilin përcakton shkaqet, përgjegjësitë dhe rekomandimet dhe sipas rastit kur konstatohet se përgjegjësia përbën veper penale, një kopje të raportit ia përcjell organeve kompetente.
7. Këqyrja e aksidentit, avarisë së rëndë në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike mund të bëhet edhe me kërkesë të pronarit, përdoruesit të pajisjes, impiantit, instalimit elektrik.

KREU V

MBIKËQYRJA DHE VLERËSIMI I KONFORMITETIT TË PAJISJEVE, IMPIANTEVE, INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Neni 12

Mbikëqyrja e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.

Pajisjet, impiantet, instalimet elektrike, me qëllim verifikimin e plotësisimit të kërkesave të këtij ligji dhe rregullave teknike të aplikueshme, u nënshtrohen inspektimit nga inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike, në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

Neni 13

Vlerësimi i konformitetit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.

1. Operatori ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve të rregullta periodike dhe atyre të veçanta (vënies fillestare në punë dhe/ose riparimeve/rikonstruksioneve) nga një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat ligjore, nënligjore dhe rregullat teknike në fuqi.
2. Organi i miratuar i vlerësimit të konformitetit mbështetur në rezultatet e inspektimit lëshon për llogari të operatorit ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike sipas rastit “Çertifikatë inspektimi” dhe/ose “Raporte inspektimi” e “Rraporte testimi”.
3. Çertifikatat e inspektimit dhe raportet e inspektimit dhe te testimi dokumentohen në librin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike dhe ruhen në bazën e të dhënave të organit të miratuar të vlerësimit të konformitetit, për një periudhë jo më pak se 10 vjet.
4. Organi i miratuar i vlerësimit të konformitetit që kryen inspektimin teknik periodik ose të veçantë, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike në rast se nga inspektimi teknik rezulton se pajisja, impianti, instalimi elektrik nuk plotëson kushtet e sigurisë, të përcaktuara në legjisllacionin dhe rregullat teknike në fuqi.
5. Inspektorati shtetëror përgjegjës në këto raste, vendos detyra dhe afate përkatëse ndaj operatorit ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime

elektrike dhe sipas rastit heqjen nga puna, shfrytëzimi të atyre pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike të cilat nuk plotësojnë kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi.

6. Inspektimet periodike të, pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike kryhen sipas afateve të përcaktuar në rregullat teknike të aplikueshme, por në çdo rast këto afate nuk duhet të tejkalojnë afatet e paraqitura me poshtë:
 - a) pajisje, impiante, instalime të vendosura në centrale të prodhimit të energjisë elektrike të çdo lloji: çdo 2 vjet;
 - b) pajisje, impiante, instalime të vendosura në nënstacione, në pika transformimi: çdo 2 vjet;
 - c) linja elektrike ajrore e kabllore me tension mbi 1 kV: çdo 3 vjet;
 - d) impiante të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike të çdo lloji: çdo vit,
 - e) impiante të tokëzimit të çdo lloji: çdo vit;
 - f) pajisje, impiante, instalime elektrike të vendosura në ambiente me rrezik zjarri dhe/ose eksplozioni: çdo vit;
 - g) pajisje, impiante, instalime elektrike të vendosura në ambiente të shërbimit mjekësor e spitalor: çdo vit;
 - h) pajisje, impiante, instalime elektrike të vendosura në ambiente të shërbimit estetik (me përdorim të pajisjeve elektrike drejtpërdrejt mbi trupin e njeriut): çdo vit.

Operatori ekonomik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, me kërkesë të tij drejtuar organizmave të miratuar të vlerësimit të konformitetit mund të kërkojë inspektime për vlerësimin e konformitetit të tyre në afate më të shkurtëra kohore se ato të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse dhe/ose ato të përcaktuara më sipër.

Neni 14

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike

Inspektorati shtetëror përgjegjës për mbikëqyrjen e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, është inspektorati shtetëror në varësinë e ministrisë përgjegjëse për energjinë elektrike.

Neni 15

Organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit

1. Organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit kryejnë inspektime teknike periodike dhe të veçanta për vlerësimin e konformitetit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, në përputhje me rregullat teknike në fuqi, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore si dhe çdo ligji e akti nënkligjor të aplikueshem.
2. Organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit pas inspektimit teknik të pajisjes, instalimit elektrik lëshojnë sipas rastit:

- a) “Çertifikatë inspektimi” për pajisjen, impiantin, instalimin elektrik, e cila përmban konstatimin se pajisja, impianti, instalimi elektrik është konform kërkesave teknike e ligjore në fuqi. Çertifikata e inspektimit në çdo rast shoqërohet me raportin/et e inspektimit dhe/ose testimin kur konstatohet se pajisjet, impiantet, instalimet nuk janë vërejtur mangësi.
 - b) “Raport/e inspektimi” dhe/ose “Raport/e testimi” për pajisjen, impiantin, instalimin elektrik, në të cilat evidentohen mangësitë e gjetura, rezultatet e matjeve dhe/ose testeve të kryera. Në rastin e konstatimit të mangësive është i detyrueshëm një ri-inspektim në një afat të justifikuar, për të konfirmuar eliminimin e mangësive të konstatuara prej operatorit ekonomik dhe/ose personit përgjegjës që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisjen, impiantin, instalimin elektrik.
 - c) “Raport inspektimi” dhe/ose “Çertifikatë inspektimit” lëshohet edhe për vlerësimin e projektin teknik elektrik të cilat respektivisht përmbajnë respektivisht konstatimin se projekti teknik i shqyrtuar përmban mangësi ose është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike të aplikueshme në fuqi.
3. Operatorët ekonomikë ose subjektet juridike që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, duhet të marrin të gjitha masat për t`ua nënshtruar ato vlerësimit të konformitetit nga organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit gjatë fazës së projektimit, montimit (instalimit) dhe shfrytëzimit të tyre.

Neni 16

Detyrat e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike kryen këto detyra:

1. Kryen inspektime tek operatorët ekonomikë publike dhe ose private që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike, ku vlerëson nëse:
 - a) ushtrimi i aktivitetit të tyre kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ligjeve dhe akteve nenligjore si dhe standardeve të aplikueshme;
 - b) pajisjet, impiantet, instalimet elektrike janë mirëmbajtur rregullisht gjatë shfrytëzimit të tyre në mënyrë të dokumentuar dhe nëse ato u janë nënshtruar vlerësimit të konformitetit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat teknike në fuqi;
 - c) punëmarrësit që montojnë, mirëmbajnë, përdorin pajisjet, impiantet, instalimet elektrike plotësojnë kushtet e përcaktuara në aktet ligjore, nenligjore e rregullat teknike si dhe kanë aftësitë dhe kualifikimet teknike e profesionale të nevojshme të vërtetuar me dëshmi aftësie.
 - d) mirëmbajtja e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ligjeve dhe akteve nenligjore dhe standardeve të aplikueshme.
2. Nëpërmjet inspektimeve ndjek zbatimin e detyrimit të operatorëve ekonomikë publike dhe private që kanë në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalimet elektrike që t'i mbajnë ato në përputhje me kërkesat e sigurisë, dhe t'ua nënshtrorjnë ato vlerësimit të konformitetit nga organizma të miratuara për këtë qëllim.

3. Mban dhe përditëson evidenca të inspektimeve të kryera, të aksidenteve dhe avarive të rënda të shqyrtuara.
4. Mban dhe përditëson regjistrin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, në pronësi dhe/ose përdorim të operatorëve ekonomike private dhe publike.
5. Bashkëpunon me Organizma të miratuara të vlerësimit të konformitetit për rritjen e ndërsjelltë të efikasitetit të inspektimit dhe vlerësimit të konformitetit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

Neni 17

Të drejtat e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike.

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike ka të drejtën të futet në mjediset ku ndodhen pajisje, impiante, instalime elektrike për kryerjen e inspektimit të tyre, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë si dhe ligjeve dhe/ose akteve nëligjore të tjera ku inspektorati shtetëror ngarkohet shprehimisht me funksione inspektimi.
2. Inspektorati shtetëror përgjegjës kërkon ndërhyrjen e forcave të rendit kur:
 - a) Inspektorit dhe/ose grupit të inspektimit i kërcënohet siguria personale, për shkak të kryerjes së detyrës;
 - b) nuk zbatohet në mënyrë të përsëritur, urdhri i ndalimit të shfrytëzimit apo heqjes nga puna të një pajisjeje, impianti, instalimi elektrik, që përbën rrezik për jetën e njerëzve, kafshëve, pronës apo mjedisit;
 - c) nuk lejohet të hyjë për kryerjen e inspektimit në mjediset ku operatorët ekonomike private dhe/ose publike mbajnë apo përdorin pajisje, impiante, instalime elektrike.
3. Për realizimin e këtyre detyrave, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike bashkëpunon edhe me organet e tjera të administratës shtetërore qendrore apo vendore.
4. Inspektorati shtetëror përgjegjës urdhëron heqjen nga puna ose përdorimi të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, në rastet kur ato nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë.
5. Inspektorati shtetëror përgjegjës, kur ka të dhëna të besueshme se në ndonjë ambient të operatoreve ekonomike private dhe/ose publike mbahen ose gjenden pajisje, impiante, instalime elektrike, të cilat nuk përmbushin kërkesat e sigurisë, ka të drejtë:
 - a) të hyjë në këto ambiente dhe të kryejë çdo procedurë inspektimi që mund të jetë e nevojshme;
 - b) të urdhërojë heqjen e menjëhershme të tyre nga puna ose përdorimi.
6. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike ka të drejtë të kërkojë nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit çdo informacion që ka të bëjë me fushën e inspektimit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, informacion

të cilin e përdor për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të tij, duke ruajtur konfidencialitetin, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Vendimi për kundërvajtjet administrative dhe ankimi

1. Inspektori i inspektoratit shtetëror përgjegjës merr vendimin për marrjen e masave urgjente, caktimin e dënimit kryesor dhe dënimeve plotësuese, në përputhje me këtë ligj, ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore të aplikueshme.
2. Në zbatim të këtij ligji dënime plotësuese konsiderohet urdhri për heqjen e pjeseshme ose të plotë nga puna (përdorimi) të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike.
3. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të këtij neni mund të bëhet ankimi në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 19

Kufizimet gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndalimet në mbarim të funksionit

Përveç sa parashikohet në ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, inspektori i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike i nënshtrohet edhe kufizimeve të parashikuara në ligjin Nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si dënim kryesor, nga inspektorati shtetëror përgjegjës përpajiset, impiantet, instalimet elektrike si më poshtë:

a) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 4, me 300 000 lekë;

Prodhimi, montimi dhe vënia në shfrytëzim e produkteve, pajisjeve, instalimeve elektrike, jo në përputhje me projektin teknik përkatës, të hartuar nga projektues të licencuar sipas legjislacionit ekzistues në fuqi;

b) për shkelje të kërkesave të pikës 3, të nenit 4, me 300 000 lekë;

Montimi i pajisjes/instalimit elektrik, kur projekti nuk i është nënshtruar vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar dhe nuk është hartuar në përputhje me rregullat dhe rregulloret teknike përkatëse;

c) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 5, me 150 000 lekë;

Montimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike kryhet nga operatorë ekonomikë instalues të pa licencuar sipas legjislacionit ekzistues në fuqi;

- d) për shkelje të kërkesave të pikave 2 e 3, të nenit 5, me nga 150 000 lekë për secilin rast;

Instaluesi kryen montimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, jo në përputhje me rregullat teknike përkatëse të sigurisë;

Instaluesi nuk plotëson dosjen me të dhëna të plota mbi produktet, pajisjet elektrike të përdorura gjatë instalimit të një pajisje, impianti, instalimi elektrik dhe nuk janë reflektuar ato në librin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike;

- e) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 6, me 300 000 lekë;

Vënja në shfrytëzim e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, të pa shoqëruara me deklaratën e konformitetit, të lëshuar nga instaluesi;

- f) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 6, me 300 000 lekë;

Montimi i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike nga subjekte instaluese të pa pajisur me licencat përkatëse sipas legjislacionit dhe akteve nenligjore në fuqi;

- g) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 7, me nga 300 000 lekë për secilin rast;

Vënia në shfrytëzim nga operatori ekonomik privat dhe/ose publik që ka në pronësi apo përdorim pajisjen, impiantin, instalimin elektrik pa bërë regjistrimin e tyre pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës;

- h) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 8, me 300 000 lekë;

Operatori ekonomik privat dhe/ose publik kryen punë elektrike (montime, instalime) pa marrë masa e nevojshme për sigurimin e jetës dhe shëndetin e punëmarrësve;

Operatori ekonomik privat dhe ose publik kryen punë elektrike, (montime, instalime) që nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi;

- i) për shkelje të kërkesave të pikës 7, të nenit 8, me 300 000 lekë;

Operatori ekonomik përdor pajisjet, impiante, instalimet elektrike nga punëmarrës që nuk kanë përgatitje të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i miratuar i çertifikimit të personelit në fushën elektrike;

- j) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 9, me 300 000 lekë;

Kryerja e punimeve (montime, instalime) në pajisje, impiante, instalime elektrike prej operatorëve ekonomikë private dhe/ose publike që kryejnë pune elektrike pa u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile;

- k) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 9, me 300 000 lekë;

Vënia në shfrytëzim e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike nga operatorët ekonomikë private dhe/ose publike që i kanë në pronësi dhe/ose përdorim ato, pa u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit të pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike;

l) për shkelje të kërkesave të pikës 2 dhe 3 të nenit 10, me nga 300 000 lekë;

Kur mirëmbajtja dhe rikonstruksioni i pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike nuk kryhet nga operatorë ekonomikë të licencuar në fushën përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, kur punëmarrësit janë të pa kualifikuar si dhe kur punëmarrësit nuk janë të pajisur me dëshmi përkatëse aftësie sipas përcaktimeve të këtij ligji.

m) për shkelje të kërkesave të pikës 3, të nenit 11, me 300 000 lekë;

Mos njoftimi menjëherë i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike nga operatori ekonomik privat dhe/ose publik ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për çdo rast aksidenti dhe/ose avarie të rëndë në pajisjet, impiante, instalimet elektrike, me pasoja për jetën, shëndetin, pronën dhe mjedisin;

n) për shkelje të kërkesave të pikës 4, të nenit 11, me 300 000 lekë;

Riparimi apo ndërhyrja në pajisjet, impiantet, instalimet elektrike në të cilat ka ndodhur një aksident, avari e rëndë pa përfunduar këqyrja nga ana e inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe/ose pa miratim paraprak prej tij;

o) për shkelje të kërkesave të pikave 1, 3 e 4, të nenit 13, me nga 300 000 lekë për secilin rast;

Mos kryerja nga operatori ekonomik privat dhe/ose publik që ka në pronësi dhe/ose përdorim pajisje, impiante, instalime elektrike të vlerësimit të konformitetit të tyre, nga një organ i miratuar;

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet, impiantet, instalimet elektrike bëhet në përputhje me ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar, ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative.
3. Të ardhurat nga masat administrative të aplikuara, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

Neni 21

Përsëritja e shkeljeve

Inspektorati shtetëror përgjegjës, në rast përsëritjeje të shkeljeve nga operatorët ekonomikë private dhe/ose publike subjekt i inspektimit, vendos ndalimin e përdorimit të pajisjes, impiantit, instalimit deri në riparimin e shkeljes.

Neni 22

Publikimi

Inspektorati shtetëror përgjegjës për inspektimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike, publikon në median e shkruar dhe ato elektronike, si dhe në faqen Web të tij, masat sanksionuese të marra ndaj operatorëve ekonomikë private dhe/ose publike, me qëllim informimin e publikut.

Neni 23

Rregullat teknike në fushën e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike

Një rregull teknik përmban minimalisht, por nuk kufizohet në: objektin të cilit i referohet lloji i pajisjes, impiantit, instalimit elektrik, kërkesat e sigurisë teknike lidhur me pajisjen, impiantin, instalimin, specifikimet teknike të shoqëruara me tabelat dhe vizatimet e nevojshme të përfuara nga përmbajtja e Standardeve shqiptare të harmonizuara ose çfardolloj dokumenti shqiptar të standardizimit të cilat organizohen në formën e “Anekseve” ose “Lidhjeve”, afatet e kryerjes së inspektimeve dhe/ose vlerësimeve të konformitetit të tyre, detyrimet dhe kërkesat për kategoritë e ndryshme të operatorëve ekonomike sipas këtij ligji si dhe listën e standardeve të harmonizuara shqiptare të aplikueshme për rastin konkret të objektit të rregullit teknik.

Rregullat teknike në fushën e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike hartohet nga ministria përgjegjëse për energjinë elektrike dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Shfuqizime

1. Ligji Nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Aktet nënligjore përfshirë rregullat teknike të nxjerra në referencë ndaj ligjit 8734/2001 vazhdojnë të mbeten në fuqi, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 25

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që me propozimin e Ministrit përgjegjës për energjinë elektrike të miratojë aktet nënligjore sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 9, dhe nenit 23, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë elektrike të nxjerrë aktet e nevojshme të përcatuara në pikën 5 të nenit 4 dhe pikën 6 të nenit 5, brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz Ruçi